



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 276/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovë dega në Malishevë, për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve, fyerjeve dhe kërcënimeve të bëra, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Malishevë

Arsyetim

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV dega në Malishevë, me të cilën pretendohet se me datën 8 qershor 2014 gjatë ditës së zgjedhjeve komisionarët e LVV-së kanë konstatuar një numër të madh të votuesve të cilët kanë me votuar me asistencë vendvotimet 3017A/01R dhe 3049A/01D në komunën e Malishevës. Si shkak i kësaj parregullsie ka reaguuar anëtari i LVV-së në KKZ Valon Hoti ndaj të cilit menjëherë kanë filluar kërcënimet dhe fyerjet nga simpatizantët dhe mbështetësit e Nismës për Kosovë ku nga persnat e identifikuar për kërcënimin e bërë ka qenë Naser Krasniqi.. Rasti në fjalë sipas parashtruesit të ankesës është njoftuar policia dhe prokuroria kompetente, pasi që sipas parashtruesit të ankesës këto veprime janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së

Lidhur me këtë çështje PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi informata më të hollësishme për këtë rast.

Në raportin e policisë të Kosovës theksohet se ankesa është pranuar nga Prokurori i shtetit dhe se lidhur me ankesën stacioni policor nuk është njoftuar për masat e ndërruara nga prokurori.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i ka gjetur se pretendimet e tilla ankimore nuk janë të mjaftueshme dhe nuk ka mundur që ti vërtetoj ato për të cilën pretendohet në ankesë, pasi që edhe nga raporti i policisë së Kosovës thuhet se ankesa në fjalë është pranuar nga prokuroria kompetente dhe se për rastin në fjalë nuk është njoftuar për ndonjë nga masat e ndërmarra nga kjo prokurori. Për më tepër, nga raporti i policisë së Kosovës drejtuar në PZAP nuk është njoftuar për parregullsinë e pretenduar me ankesë dhe se mbi këtë bazë PZAP-i vlerëson se ankesa në fjalë është si e pa bazë, dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 276/2014 më datën 12.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*